



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KRYETARI

Nr. 1430 regj.

Ballsh, më 24.03.2023

NJOFTIM

Në zbatim të Ligjit Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, i ndryshuar, Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Ligji nr 45 /2019 “ Për Mbrojtjen Civile ”bashkia Mallakastër do të realizoj dëgjese publike me banore dhe grupe interesi per pregatitjen e raportit te vlerësimit të riskut .

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, (UNDP/PNUD) në Shqipëri po mbështet përpjekjet e vendit për përmirësimin e sistemit dhe kapaciteteve të menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë (MRF) - në nivel qendror dhe vendor. Qëllimi i përgjithshëm i projektit RESEAL është forcimi i sistemit të MRF-së në Shqipëri dhe mbështetja e përpjekjeve të vendit për t’u bërë një anëtar i plotë i Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të BE-së (MMC BE). Në kuadër të projektit RESEAL, është kryer “Zhvillimi i vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel vendor” për të gjashtë bashkitë e Qarkut Fier, përfshirë Bashkinë Mallakastër, nën koordinimin dhe bashkërendimin e Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen Civile si edhe Prefektit të Qarkut Fier . Projekti po mundëson hartimin e dokumenteve me fokus vlerësimin e risqeve të fatkeqësive për Bashkinë Mallakastër. Projekti ka në fokus vlerësimin e kapaciteteve përbaluese dhe vlerësimin e riskut për secilën bashki për gjashtë rreziqe kryesore: tërmetet, përmytjet, zjarret në pyje, rrëshqitjet, rreziku biologjik dhe rreziku teknologjik.

Për të diskutuar së bashku mbi këtë vlerësim dhe për të ndarë rekomandimet tuaja, do të zhvillojmë një dëgjese publike. Takimi do të zhvillohet **ditën e enjte datë 13.04.2023 ora 13 : 00** në ambientet e sallës së pallatit të kulturës “ Dino Kalenja ” Ballsh .

Jeni të ftuar të bëheni pjesë e dëgjesës publike për pregatitjen e raportit të vlerësimit të riskut të Bashkisë Mallakastër për të garantuar një proces sa më transparent dhe gjithëpërfshirës!

KRYETAR

Qerim Ismajaj

